

Intervistë e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorit Pavel Vacek

Gazetare: Ilva Tare

Përsëri Shqipëria nuk arriti të kishte zgjedhje të lira dhe demokratike, por u tha se ato ishin pjesërisht sipas standardeve. A ndjeheni përgjegjës për këtë, meqenëse keni dhënë asistencë gjatë reformimit të procesit zgjedhor?

Ne jemi përgjegjës për asistencën e ofruar dhe jo për rezultatet. Ato janë gjithmonë dhe plotësisht në dorë të përfaqësuesve politikë të Shqipërisë.

Partitë e vogla e akuzojnë OSBE-në se ka dështuar në Shqipëri me reformat zgjedhore të herëpashershme. Sipas tyre, OSBE-ja ka rënë në kurthin e partive të mëdha dhe ka injoruar interesat e partive të vogla, duke dëgjuar vetëm dy partitë e mëdha. Si i përgjigjeni kësaj akuze?

Siç e dimë të gjithë, akuzat janë gjithmonë të vështira, por unë mendoj se kurthi më i madh në të cilin njerëzit mund të bien është të fajësojnë organizatat ndërkombëtare. Unë mendoj se çështja kryesore është nëse të gjithë partnerët në skenën politike shqiptare kanë qenë reciprokisht të hapur dhe të vëmendshëm ndaj njëri-tjetrit. Ne, sigurisht, i dëgjojmë gjithmonë njerëzit dhe i njohim shqetësimet. Se në çfarë shkalle këto shqetësime kanë qenë pjesë e çfarëdo konsensusi që qëndron në themel të Kodit aktual Zgjedhor, kjo është një çështje tjetër.

Ndoshta ju e konsideruat atë të mjaftueshëm për arritjen e konsensusit midis dy partive kryesore?

Pa dyshim, ky konsensus ishte çelësi për miratimin e Kodit Zgjedhor.

Pas çdo zgjedhjeje, lind gjithnjë nevoja për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe pasi kjo realizohet, bëhet përsëri thirrje për përmirësime të tjera. Çfarë nuk funksionon siç duhet me këto ndryshime?

Kjo është gjithmonë e lidhur me shkallën e përparimit. Pa dyshim, komentet dhe rekomandimet e bëra në secilat nga zgjedhjet e mëparshme kanë pasur për qëllim çuarjen më tej të këtij përparimi. Kjo do të thotë përafrim i standardeve sipas interpretimit të ODIHR-it dhe kjo na çon ne në raportin e publikuar së fundmi nga ODIHR-i në lidhje me zgjedhjet e fundit në Shqipëri.

A kishte OSBE-ja ndonjë mundësi për ta frenuar përpara zgjedhjeve fenomenin Dushk, që, në raport, thuhet se cenoi edhe Kushtetutën?

Ka një numër përgjigjesh për pyetjen që shtroni, të cilat janë përfshirë edhe në raport. Kjo ka qenë më tepër një çështje për partitë politike shqiptare dhe njihet gjerësisht nga të gjitha palët e interesuara, në veçanti, ato të interesuara drejtpërdrejt, d.m.th., vetë partitë politike, se ka patur shqetësime në lidhje me mekanikat e këtyre

marrëveshjeve për një votim strategjik, që u janë bërë të ditura edhe partive. Në një farë mënyre, ndikimet deformuese të këtyre marrëveshjeve strategjike të votimit u kthyen kundër atyre, që në fakt, i promovuan ato të parët.

Doni të thoni se faji është i partive politike dhe se OSBE-ja nuk mundi të bënte asgjë për ta parandaluar atë?

Pa dyshim që OSBE-ja, ashtu si organizata të tjera ndërkombëtare, as nuk mund të bëjë që gjërat të ndodhin dhe as nuk mund të parandalojë që gjërat të ndodhin. Roli i saj është këshillues, asistues dhe jo ndërhyrës. Unë mendoj se shqetësimet iu bënë prezente shumë aktorëve në skenën politike dhe ata e dinë shumë mirë këtë.

Sipas raportit të ODIHR-it, aplikimi i skemës së Dushkut shkoi deri aty sa shkeli Kushtetutën. Në këtë kontekst, a e konsideroni Kuvendin aktual të ligjshëm?

Së pari, unë nuk do të jap ndonjë gjykim, sepse, para së gjithash, kjo ka të bëjë me formulimet që përfshihen në raport. Nuk mendoj se raporti thotë se ky zbatim i marrëveshjeve për votim strategjik ishte jokushtetues dhe, së dyti, ka të bëjë me efektet deformuese të këtyre marrëveshjeve, dhe gjykimi nese ato ishin apo jo kushtetuese nuk na takon ne ta japim.

A do të mbeteni një partner në procesin e reformës zgjedhore, edhe pse disa parti të vogla nuk do të donin t'ju shihnin ju si pjesë e një procesi të tillë?

Asistenca për çuarjen më tej të reformës zgjedhore është një prej detyrave të përfshira në mandatin tonë, kështu që nuk ka vend për pyetje nëse do të japim asistencë apo jo. Çështja tjetër ka të bëjë me konsensusin mbi parametrat themelorë të çuarjes më tej të reformës zgjedhore. Kjo duhet arritur nga vetë partitë politike shqiptare. Dhe, nuk po e them këtë për herë të parë, ne do të ishim shumë të kënaqur nëse ky konsensus arrihet nga vetë aktorët politikë pa ndonjë ndërmjetësim apo përfshirje të jashtme dhe atëherë ne mund të ndërhyjmë me ekspertizë teknike në hartimin legjislativ kur të vijë momenti.

Nuk jeni lodhur nga të gjitha këto negociata?

Debati sapo ka filluar dhe është mirë që ka filluar. Mbetem në pritje të marrëveshjes që do të dalë mbi konturet kryesore të themeleve të reformës zgjedhore dhe mendoj se mund nevojitet më shumë kohë deri atëherë.

Ashtu siç ka ndodhur zakonisht, raporti dhe rekomandimet janë lexuar në mënyra të ndryshme nga njerëz të ndryshëm. Disa prej tyre thonë se ndryshimi i sistemit zgjedhor kërkohet në raportin e ODIHR-it, ndërsa disa të tjerë thonë se raporti nuk e sugjeron këtë gjë. Çfarë mendoni për këtë?

Raporti, sigurisht, që nuk dikton një gjë të tillë. Ai bën disa rekomandime që kanë lidhje me Kodin aktual Zgjedhor, por nuk mendoj se është në logjikën e punës së ODIHR-it që të japë receta për zgjidhje. Për këtë arsye, kjo është lënë e hapur dhe në dorë të përfaqësimit politik të vendit. Kjo na çon pikërisht tek raporti që duhet të lexohet nga të gjithë ata që janë të interesuar për ta çuar përpara reformën dhe unë kam shumë besim se raporti është bërë një material referimi jo vetëm për partitë

politike por edhe, për shembull, për komisionin e posaçëm të ngritur nga Kuvendi dhe kjo shkon përtej komenteve të shkurtra që mund të bëhen në këtë rast.

Z. Ambasador, nuk keni ndonjë koment tuajin për këtë çështje?

Jo pikërisht ashtu. Unë nuk do të interpretoja raportin e ODIHR-it, sepse do të ketë një mundësi për ta pasur një prezantim të tillë nga personi më kompetent për këtë, domethënë, Drejtori i ODIHR-it, i cili do të vijë së shpejti në Shqipëri, dhe një nga qëllimet e vizitës së tij është të paraqesë konstatimet dhe rekomandimet e raportit.

Ka pasur propozime, veçanërisht, nga partitë e vogla për ndryshimin e sistemit zgjedhor në sistem proporcional apo proporcional rajonal. Për cilin prej tyre do të ishit pro?

Është një zgjedhje që duhet bërë nga aktorët shqiptarë. Kjo është pikërisht një prej çështjeve themelore që duhet zgjidhur nga aktorët politikë shqiptarë dhe jo nga institucionet ndërkombëtare. Pikërisht për këtë arsye, ODIHR-i nuk ka bërë ndonjë rekomandim apo përcaktuar ndonjë zgjedhje në këtë drejtim. Kjo sepse dihet se sisteme të ndryshme zgjedhore kanë avantazhe dhe disavantazhe në lidhje me rrjedhojat dhe ndikimin e tyre mbi skenën politike dhe jetën e vendit. Ekzistojnë praktika të vendeve të ndryshme që u përmbahen sistemeve të ndryshme zgjedhore, dhe këto duhen parë, por askush nuk mund të përcaktojë një zgjedhje të veçantë në këtë drejtim.

Sipas informacionit që ju keni marrë nga monitorimi i zgjedhjeve, çfarë nuk shkoi siç duhet ishte sistemi zgjedhor apo infrastruktura zgjedhore?

Ndoshta, është një element i tretë që ju nuk e përmendët, dhe kjo është qëndrimi i partive politike përsa i përket ndikimit të tyre të panevojshmëm mbi administratën zgjedhore. Ky është ndoshta edhe thelbi i problemit dhe kjo përshkruhet mjaft qartë në vetë raportin e ODIHR-it.

Me kë nga autoritetet shqiptare ju duket më e lehtë për të bashkëpunuar, Presidentin apo Kuvendin?

Kësaj pyetjeje nuk mund t'i jepet përgjigje. Normalisht, unë kam kontakte pune me një sërë institucionesh dhe zyrtarësh shqiptarë dhe e vlerësoj shumë bashkëpunimin që kam si me zyrën e Presidentit, ashtu edhe me Kuvendin. Besoj se kaq mjafton, këto janë gjëra që dihen dhe nuk ka nevojë të shkohet më tej.

Pyetja e fundit. Do të largohem nga kjo intervistë pa kuptuar se i kujt ishte faji për problemet serioze në zgjedhjet e 3 korrikut...

Problemi qëndron se kërkohet se kujt t'i hidhet faji. Kjo ndoshta nuk na çon shumë larg. Nëse kërkohet si e si të fajësojmë dikë, nuk zgjidhim gjë. Në të vërtetë, ato që duhen kërkuar janë zgjedhjet. Dhe ky do të ishte sugjerimi im.